

LIGJ  
Nr.9154, date 6.11.2003

PER ARKIVAT

Ne mbështetje te neneve 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I  
OBJEKTI DHE PERKUFIZIME

Neni 1

Ky ligj përcakton rregullat baze për organizimin e funksionimin e shërbimit arkivor ne Shqipëri, institucionet qe kryejnë tete shërbim, si dhe detyrimet e tyre ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, si pjese e trashëgimisë kombëtare.

Neni 2

Ne këtë ligj, termat e mëposhtëm kane këto kuptime:

1. "Arkiva" janë institucionet shtetërore ose joshtetërore te specializuara, qe mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe shërbejnë pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Arkiva janë edhe njësitë strukturore e nenstrukturore te institucioneve te administratës shtetërore qendrore e vendore, qe evidencojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vene ne shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre.
2. "Arkiv" është çdo pasuri dokumentare qe ruhet prej institucioneve te përcaktuara ne piken 1 te këtij neni, si dhe çdo pasuri dokumentare e krijuar ose e ruajtur prej subjekteve joshtetërore, juridike e fizike private.
3. "Autoritet publik" janë organet përfaqësuese te pushtetit qendror dhe vendor; institucionet e administratës, qendrore dhe vendore te pushteteve kushtetuese; personat juridike dhe fizike, ne masën qe ata përmbushin funksione publike ose ushtrojnë një detyre administrative, sipas ligjeve ne fuqi.
4. "Dokumente me rëndësi historike kombëtare" janë te gjitha aktet qe kane vlere ruajtjeje te përhershme dhe shpallen si te tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për shkak te rëndësisë juridiko-administrative, historike, shkencore dhe kulturore për trashëgiminë e popullit shqiptar.
5. "Dokumente" janë te gjitha aktet e krijuara nga autoritetet publike, gjate ushtrimit te veprimtarisë se tyre ne funksione administrative; aktet e krijuara nga institucionet joshtetërore, si dhe subjektet juridike e fizike private, kur vlerësohen me rëndësi historike kombëtare.
6. "Fondi arkivor kombëtar" është e gjithë pasuria dokumentare, shtetërore e joshtetërore, me vlere ruajtjeje te përhershme ose te përkohshme, ne administrim te arkivave shtetërore a private.
7. "Kërkuës" është personi qe ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shërbim arkivor, e cila i është miratuar, me përjashtim te vete personelit te brendshëm te arkivave.

8. "Komunikim" është detyrimi ligjor i arkivave shtetërore për të vënë në dispozicion dhe për t'u shërbyer institucioneve dhe individëve dokumentet që ato ruajnë dhe përmbushja e kësaj përgjegjësie ligjore.

9. "Rrjet arkivor" është tërësia e institucioneve në varësi të drejtpërdrejte, si dhe e atyre që kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, përshkruar sipas nenit 9 të këtij ligji.

10. Shfrytëzim i arkivave" është mundësia e përdorimit të dokumenteve arkivore, në funksion të njohjes me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe e drejta për shërbim me dokumente për qëllime studimore-shkencore ose për nevoja vetjake.

## KREU II

### FONDI ARKIVOR KOMBETAR

#### Neni 3

1. Fondi arkivor kombëtar është tërësia e dokumenteve të krijuara, të dërguara dhe të pranuar, gjatë veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose joshtetërore, të personave juridike e fizike private, pavarësisht nga koha, vendi, pronësia, mënyra e krijimit dhe lloji i tyre, me vlerë historike kombëtare juridike, politike, ekonomike, sociale e kulturore.

2. Emërtimi i dokumenteve, që përbejnë fondin arkivor kombëtar, shpallet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe është i njësuar në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

#### Neni 4

Në fondin arkivor kombëtar bëjnë pjesë edhe dokumentet e krijuara nga institucionet e administratave shtetërore të huaja, që kanë vepruar në hapësirën historike shqiptare para shpalljes së Pavarësisë, si dhe dokumentet e organizatave, shoqërive dhe personaliteteve shqiptare, që e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre jashtë shtetit.

#### Neni 5

1. Fondi arkivor kombëtar dhe arkivat mbrohen dhe sigurohen nga shteti, sipas kërkesave të këtij ligji.

2. Shteti shqiptar njihet detyrimet për mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare, që rrjedhin nga aktet juridike ndërkombëtare, ku ai është pale nënshkruese.

#### Neni 6

1. Dokumentet e subjekteve shtetërore e joshtetërore, si dhe të personave juridike e fizike private, që janë bërë pjesë e fondit arkivor kombëtar para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor dhe për arkivat", janë të pakthyeshme, pavarësisht nga mënyra e hyrjes në arkivat shtetërore, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjen e pranimit.

2. Dokumentet që përbejnë fondin arkivor kombëtar nuk dalin jashtë vendruajtjes së përhershme, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Në ato raste kur dokumenti del jashtë vendruajtjes, shoqërohet nga një punonjës i autorizuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Pas përfundimit të veprimeve procedurale të domosdoshme, dokumenti kthehet në vendruajtjen e përhershme dhe nëse është e nevojshme përdoret përsëri sipas së njëjtës procedure.

#### Neni 7

1. Përcaktimi i vlerës dhe i afateve të ruajtjes së dokumenteve të arkivave në veprim të institucioneve shtetërore bëhet nga komisionet e ekspertizës, që funksionojnë pranë këtyre

institucioneve. Vendimet e tyre miratohen nga komisionet e ekspertizës, qe funksionojnë pranë arkivave respektive te një shkalle me lart, te përshkruar sipas nenit 9 te këtij ligji.

2. Asgjësimi i dokumenteve, qe e humbasin vlerën e ruajtjes, behet nga institucionet qe i kane ato ne administrim, sipas rregullave te përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

## Neni 8

Institucionet shtetërore ose joshtetërore, si dhe personat juridike e fizike private qe kane dokumente te shpallura me rëndësi historike kombëtare, janë te detyruara te dërgojnë te dhëna informuese për efekt regjistrimi ne arkivat shtetërore respektive, te përshkruar ne nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji.

## KREU III

### ORGANIZIMI I RRJETIT ARKIVOR

## Neni 9

1. Fondi arkivor kombëtar ruhet, përpunohet, administrohet dhe shërbehet nga rrjeti arkivor i Republikës se Shqipërisë.

2. Rrjeti arkivor i Republikës se Shqipërisë përbëhet nga:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

b) Arkivi Qendror Shtetëror;

c) arkivat shtetërore qe ruajnë dokumente te se njëjtës tipologji (Arkivi Qendror i Filmit, Arkivi Qendror Teknik);

ç) arkivat shtetërore te sistemit, qe funksionojnë ne mënyrë te përhershme pranë institucioneve qendrore fondkrijuese;

d) arkivat shtetërore vendore;

dh) arkivat ne veprim te institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore;

e) arkivat private.

3. Krijimi i arkivave te rinj shtetërore, sipas pikës 2 shkronjat "c" dhe "ç" te këtij neni, behet me vendim te Këshillit te Ministrave.

## Neni 10

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është organi me i larte i rrjetit arkivor kombëtar. Ajo është institucion qendror ne varësi te Kryeministrit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është person juridik. Ajo ka vulën dhe stemën e vet. Selia e saj ndodhet ne Tirane.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet dhe lirohet nga detyra prej Kryeministrit.

## Neni 11

1. Drejtori i Përgjithshëm është titullari i institucionit. Ai kryen këto detyra:

a) përgjigjet përpara Këshillit te Ministrave për veprimtarinë e institucionit;

b) miraton rregullore, urdhra dhe udhëzime te detyrueshme për zbatim, ne mbështetje te legjislacionit arkivor;

c) miraton planet vjetore te drejtorive qe funksionojnë pranë Drejtorisë se Përgjithshme dhe ato te drejtorive te arkivave shtetërore vendore;

ç) përfaqëson arkivat shtetërore te vendit ne organizmat dhe institucionet ndërkombëtare ku ato janë anëtarësuar dhe ushtron te drejtën e votës ne emër te tyre.

2. Drejtori i Përgjithshëm kryen detyra te tjera te parashikuara nga Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit te Drejtorisë se Përgjithshme te Arkivave.

## Neni 12

1. Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, drejtuesit, specialistet dhe arkivistet, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohet legjislacioni i Kodit të Punës.
2. Rekrutimi i punonjësve, mënyra e pranimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyre dhe largimit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
3. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë në vende pune që konsiderohen pjesë e shërbimit civil, janë nëpunës në periudhë prove për 1 vit.

## Neni 13

1. Në varësi të drejtpërdrejte administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave janë Arkivi Qendror Shtetëror dhe arkivat shtetërore vendore.
2. Arkivat e tjerë, që bëjnë pjesë në rrjetin arkivor kombëtar, të përshkruar në nenin 9 shkronjat "c", "ç", "dh" dhe "e", kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

## Neni 14

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave funksionojnë: Këshilli i Lartë i Arkivave, Komisioni Qendror i Ekspertizës, Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" dhe Komisioni i Përhershëm i Eksperteve të Vlerësimit të Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare.
2. Këshilli i Lartë i Arkivave harton dhe miraton politikën arkivore dhe strategjinë e zhvillimit të shërbimit arkivor.
3. Komisioni Qendror i Ekspertizës shqyrton dhe miraton listat e dokumenteve për asgjësim, sipas vendimit të propozuar prej komisioneve të ekspertizës, që funksionojnë pranë institucioneve shtetërore, të cilat i dorëzojnë dokumentet e tyre në Arkivin Qendror Shtetëror.
4. Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" bën deklasifikimin e dokumenteve, që kanë hyrë të klasifikuara në Arkivin Qendror Shtetëror dhe në arkivat shtetërore vendore, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"".
5. Statusi, rregullat, përbërja dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Lartë të Arkivave, të Komisionit Qendror të Ekspertizës, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" dhe të Komisionit të Përhershëm të Eksperteve për Vlerësimin e Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

## Neni 15

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor dhe organizon, drejton e kontrollon zbatimin e njësuar të saj në veprimtarinë e të gjithë rrjetit arkivor të vendit.
2. Për krijimin e normës tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave mbështetet në legjislacionin e vendit dhe në aktet e marrëveshjet themelore ndërkombëtare, të pranuar në rang ndërkombëtar, në këtë ligj dhe në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.
3. Rregullat e miratuara prej kësaj drejtorie, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji, janë të

detyrueshme për zbatim ne te gjithë rrjetin arkivor te vendit.

#### Neni 16

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ushtron te drejtën e përfaqësimit dhe te votës, ne emër te shtetit shqiptar, ne organizatat ndërkombëtare ku është anëtarë.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nënshkruan marrëveshje dy ose shumëpalëshe me institucionet respektive te vendeve te tjera për pasurimin e fondit arkivor kombëtar, për publikimin, shkëmbimin e përvojave, përgatitjen dhe kualifikimin e specialisteve.

#### Neni 17

Arkivi Qendror Shtetëror ruan, përpunon, administron dhe shërben:

- a) dokumentet qe janë trashëguar nga shteti shqiptar nga periudha parashtetërore;
- b) dokumentet qe janë krijuar nga institucionet qendrore e vendore te administratës shtetërore deri ne vitin 1944;
- c) dokumentet e institucioneve qendrore te administratës shtetërore dhe te organeve udhëheqëse partiake, te krijuara deri ne vitin 1991;
- ç) dokumentet e institucioneve qendrore te administratës shtetërore pa kufizim kohor, me përjashtim te atyre qe ruhen ne arkivat e sistemit ose ne arkivat qe ruajnë akte te se njëjtës tipologji;
- d) dokumentet qe janë krijuar prej institucioneve te tjera shtetërore joqendrore pas vitit 1944, por janë te vetme ne llojin e tyre;
- dh) dokumentet qe janë krijuar prej subjekteve e personave juridike dhe fizike private, te kaluara ne pronësi te shtetit para hyrjes ne fuqi te ligjit nr.7726, date 29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat".

#### Neni 18

Arkivi Qendror Shtetëror ruan, administron dhe shërben trashëgiminë dokumentare joadministrative, te krijuar ne hapësirën shqiptare gjate shekujve, pavarësisht nga fondkrijuesi, gjuha, alfabeti, përmbajtja apo tipologjia e shkrimit.

#### Neni 19

1. Arkivat shtetërore, qe ruajnë dokumente te se njëjtës tipologji janë Arkivi Qendror i Filmit dhe Arkivi Qendror Teknik.
2. Këta arkiva kontrollojnë zbatimin e këtij ligji dhe japin ndihme metodologjike e profesionale ne arkivat vendore, ku ruhen dokumentet e se njëjtës tipologji.

#### Neni 20

1. Arkivat shtetërore te sistemit funksionojnë pranë këtyre institucioneve: Ministrisë se Mbrojtjes, Ministrisë se Rendit Publik, Ministrisë se Punëve te Jashtme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror .
2. Institucioni i Kuvendit te Shqipërisë dhe ai i Presidentit i administrojnë dokumentet respektive ne arkiva qe funksionojnë ne mënyrë te përhershme pranë tyre.
3. Arkivat shtetërore te sistemit funksionojnë pranë institucioneve shtetërore, te cilat, sipas Kushtetutës se Republikës te Shqipërisë, janë institucione te pavarura.
4. Arkivi shtetëror i sistemit te drejtësisë (gjykatat e prokuroritë) krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë se Drejtësisë.
5. Arkivat e sistemit funksionojnë sipas kërkesave te këtij ligji.

#### Neni 21

1. Arkivat shtetërore te sistemit administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e krijuara gjate veprimtarisë së institucioneve që, sipas ligjit, e dorëzojnë pasurinë arkivore pranë tyre. Ata kontrollojnë zbatimin e ligjit dhe japin ndihme metodike në arkivat e institucioneve shtetërore të varësisë së tyre.
2. Arkivat shtetërore të sistemit janë në varësi administrative të drejtpërdrejte të drejtuesit të institucionit.

#### Neni 22

1. Arkivat shtetërore vendore administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e arkivave të institucioneve shtetërore vendore dhe të organeve të qeverisjes vendore, që veprojnë brenda njësisë administrativo-territoriale përkatëse. Ata kontrollojnë dhe japin ndihme metodike në arkivat e pushtetit vendor dhe të institucioneve shtetërore vendore, që veprojnë në njësinë administrativo-territoriale përkatëse.
2. Arkivat shtetërore vendore janë të detyruar të regjistrojnë çdo pasuri dokumentare joadministrative, që ekziston në territorin e njësisë së tyre administrativo-territoriale.
3. Këto pasuri i bëhen të ditura menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror.

#### Neni 23

1. Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore janë pjesë organike e tyre dhe varen drejtpërdrejt nga drejtuesi i institucionit.
2. Në varësi të vëllimit të dokumenteve që krijohen, pranë çdo institucioni shtetëror funksionojnë: sekretaria dhe arkivi, sekretari-arkivi ose punonjësi i ngarkuar me shërbimin në sekretari-arkiv.

#### Neni 24

Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë:

- a) të evidentojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni;
- b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë;
- c) të dorëzojnë dokumentet në arkivat shtetërore, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të këtij ligji.

### KREU IV ARKIVAT PRIVATE

#### Neni 25

1. Arkivat private e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pasi licencohen nga Këshilli i Lartë i Arkivave me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kriteret për licencim përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.
2. Pasuritë, që administrohen në arkivat private, gëzojnë të njëjtën mbrojtje nga shteti si ato të arkivave publike.

#### Neni 26

1. Pasuri të arkivave private, për arsye historike ose me interes publik, mund të shpallen dokumentet me rëndësi historike kombëtare. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, si dhe arkivi privat kanë të drejtën e nismës, ndërsa të drejtën e vendimit të shpalljes e ka Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave.
2. Shpallja "dokumente me rëndësi historike kombëtare" e pasurive dokumentare, që ruhen në arkivat private, nuk cenon, kufizon ose ndryshon marrëdhënien e pronësisë.

3. Përfaqësuesi i arkivit privat ka te drejte te kërkojë ndryshimin e përcaktimit te dokumenteve ne pronësi te tij, te shpallura me rëndësi historike kombëtare. Vendimi për ndryshimin e statusit te dokumenteve te shpallura me rëndësi historike kombëtare merret ne te njëjtën forme, me te njëjtën procedure dhe nga te njëjtat autoritete, si ne rastin e shpalljes se tyre si te tilla.

#### Neni 27

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, kur nis procedurën për shpalljen e dokumenteve ne pronësi te arkivave private, si dokumente me rëndësi historike kombëtare, njofton menjëherë pronaret ose përfaqësuesit e këtyre te fundit.
2. Efektet ligjore te vendimit hyjnë ne fuqi një dite pas shpalljes.

#### Neni 28

1. Dokumentet e arkivave private, qe shpallen me rëndësi historike kombëtare nuk kane afat te parashkrueshem. Shpallja e tyre si te tilla nuk është pengese për transferimin e te drejtës se pronësisë dhe te te drejtave te tjera mbi këto dokumente.

#### Neni 31

2. Arkivat private, qe kane ne pronësi dokumente te shpallura me rëndësi historike kombëtare, ne rastin e ndryshimit te pronësisë, janë te detyruara t'i bëjnë te njohur paraprakisht blerësit statusin e dokumenteve te tyre.

#### Neni 29

1. Asgjësimi i dokumenteve te shpallura me rëndësi historike kombëtare, ne pronësi te arkivave private, është i ndaluar.
2. Asgjësimi i dokumenteve qe e kane plotësuar afatin ligjor te ruajtjes, prone e arkivave private, behet me te njëjtat procedura si për arkivat shtetërore. Ligjshmëria e vendimit për asgjësim miratohet zyrtarisht dhe me shkrim nga autoritetet e arkivave shtetërore përkatës.

#### Neni 30

Dokumentet e shpallura me rëndësi historike kombëtare, ne pronësi te arkivave private, nuk mund te shiten dhe te dhurohen jashtë vendit.

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, ne cilësinë e përfaqësuesit te shtetit shqiptar, gëzon te drejtën e parablerjes se dokumenteve te shpallura me rëndësi historike kombëtare, qe ndodhen ne pronësi te subjekteve private.
2. Kur subjektet private dëshirojnë te shesin dokumente te shpallura me rëndësi historike kombëtare, ato duhet te paraqesin pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Arkivave përshkrimin e tyre, ne përputhje me normën e njësuar ne fuqi. Subjekti privat qe ka ne pronësi dokumente te tilla është i detyruar te paraqesë me shkrim te dhënat e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, pas këshillimit te te dhënave pershkrimore, te vlerësuara nga Komisioni i Përhershëm i Eksperteve, vendos për dhënien ose jo te lejes për shitjen, si dhe për kushtet e tregtimit te këtyre dokumenteve. Ne çdo rast Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është e detyruar t'i ktheje përgjigje pronarit te dokumenteve brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit te te dhënave pershkrimore për to. Kundër vendimit te dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, personi ka te drejtën e ankimit ne gjyrate, sipas Kodit te Procedurave Administrative.

## Neni 32

Shteti liron nga detyrimet vjetore fiskale pronaret e arkivave private, qe u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente te shpallura me rëndësi historike kombëtare, ne përputhje me ligjin nr.7892, date 12.12.1994 "Për sponsorizimet".

## Neni 33

Arkivat private, qe administrojnë dokumente te shpallura me rëndësi historike kombëtare janë te detyruar te bëjnë regjistrimin e tyre ne evidencën e arkivave shtetërore, qendrore ose vendore dhe ne përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore. Regjistrimi i tyre behet jo me vone se një vit nga hyrja ne fuqi e këtij ligji.

Me mbarimin e këtij afati, çdo tjetërsim ose shitblerje e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare ne pronësi te tyre është i paligjshëm.

## Neni 34

1. Pronaret e arkivave private, qe u dhurojnë ose u shesin arkivave shtetërore dokumente me rëndësi historike kombëtare, gëzojnë te drejtën e pronësisë intelektuale, sipas legjislacionit ne fuqi.

2. Këto te drejta i gëzon çdo subjekt privat për dokumentet e krijuara jashtë funksioneve shtetërore.

## Neni 35

1. Kur subjektet shtetërore privatizohen, dokumentet e tyre mbeten prone e shtetit. Institucionet e administratës shtetërore, qe bëjnë privatizimin, janë te detyruara te dorëzojnë paraprakisht ne arkivat shtetërore përkatës, qendrore ose vendore, arkivat e subjekteve shtetërore qe privatizohen.

2. Autoritetet e arkivave shtetërore vendosin për dhënien e pjeshme ose te plote te kopjeve te dokumenteve, qe lidhen me tekniken dhe teknologjinë e prodhimit, pronarit te ri joshtetëror, me kërkesën e këtij te fundit. Shpenzimet e riprodhimit te dokumenteve janë te palës kërkuese.

## KREU V

### ARKIVAT E NUMERIZUAR

## Neni 36

1. Dokumentet e numerizuara, pavarësisht nga forma e regjistrimit dhe e qarkullimit, kane vlere administrative e juridike vetëm nëse janë hartuar e janë ruajtur sipas standardeve te miratuara.

2. Përshkrimi ligjor i dokumentit te numerizuar behet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet shtetërore te shërbimit informatik. Ato përgatisin rregulla te detyrueshme për hartimin, evidencimin, qarkullimin, përpunimin tekniko-shkencor, ekspertizën e vlerës se ruajtjes e asgjësimit, si dhe për ruajtjen, dublikimin, riprodhimin dhe legalizimin e dokumenteve te numerizuara. Këto rregulla miratohen nga Këshilli i Ministrave.

## Neni 37

Dokumentet e numerizuara janë te vlefshme si pasuri arkivore nëse janë regjistruar ne forme te pandryshueshme qe ne aktin e krijimit.

## Neni 38



Kalimi i dokumentit qe është krijuar ne bartës material (letër, pergamene) ne dokument, ne forme te numerizuar, behet duke ruajtur njeshmerine me origjinalin.

Neni 39

Dokumentet e numerizuara ruhen pranë arkivave te institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore. Ne mbarim te afatit ligjor te ruajtjes pranë tyre, ato dorëzohen ne arkivat shtetërore respektive, sipas përshkrimit ne nenin 9 te këtij ligji.

Neni 40

Institucionet fondkrijuese te dokumenteve te numerizuara dorëzojnë pranë arkivave përkatës, ne te njëjtët bartës qe kane regjistruar dokumentet, edhe mjetet e informimit dhe te kërkimit arkivor.

Neni 41

1. Arkivat e numerizuar janë pjese e rrjetit arkivor kombëtar. Arkivat e numerizuar i nënshtrohen se njëjtës disipline ligjore për ruajtjen, komunikimin dhe shërbimin.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka te drejtën e përcaktimit te programeve te numerizimit te dokumenteve ne institucionet fondkrijuese.

KREU VI

DOREZIMI I DOKUMENTEVE NE ARKIVAT SHTETERORE

Neni 42

1. Dokumentet arkivore, me mbarimin e afatit te shërbimit operativ pranë arkivave te institucioneve fondkrijuese, dorëzohen nga këto te fundit për ruajtje dhe administrim ne arkivat shtetërore, ne përputhje me nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji, te sistemuara dhe te inventarizuara, sipas rregullave te përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Bashke me dokumentet dorëzohen:
  - a) dy kopje te inventarit;
  - b) një kopje inventari ne regjistrim te numerizuar, qe përputhet me programin e informatizimit te aktivitetit, ku dorëzohen dokumentet.

Neni 43

- Dorëzimi i dokumenteve te institucioneve shtetërore ne arkivat përkatës, përshkruar sipas nenit 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji, behet sipas këtyre afateve normative:
- a) dokumentet administrative dorëzohen pasi te kenë kaluar 10 vjet nga data e krijimit te tyre. Ky afat është i detyrueshëm edhe për dokumentet ne figure, ne zë e ne lëvizje, qe përbejnë dokumente administrative;
  - b) dokumentet tekniko-shkencore dorëzohen pas mbarimit te nevojave për shërbim operativ, por jo me vone se 25 vjet nga viti i krijimit te tyre;
  - c) dokumentet ne figure, ne zë e ne lëvizje dorëzohen pasi te kenë kaluar 15 vjet nga data e krijimit te tyre;
  - ç) regjistrat e akteve te gjendjes civile dorëzohen pasi te kenë kaluar 75 vjet nga data e krijimit te tyre;
  - d) dokumentet e klasifikuara "sekret shtetëror" dorëzohen pas deklasifikimit te tyre. Deklasifikimi behet nga autoriteti klasifikues.

Neni 44

Dokumentet e institucioneve qendrore e vendore te administratës shtetërore dorëzohen ne rrjetin shtetëror te arkivave drejtpërdrejt nga institucioni qe i ka krijuar.

#### Neni 45

1. Arkivat e institucioneve qendrore e vendore te administratës shtetërore, qe e mbyllin veprimtarinë e tyre për çfarëdo lloj shkaku, dorëzohen menjëherë pranë arkivave përkatës, sipas nenit 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji.
2. Kur funksionet ose atributet e një institucioni shtetëror barten ligjërisht te një institucion tjetër, ky i fundit mund te administroje dokumentet e trashëguara deri ne mbushjen e afateve te parashikuara ne nenin 43 te këtij ligji.

#### Neni 46

1. Institucionet arkivore shtetërore te përshkruara ne nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" te këtij ligji kane te drejte te tërheqin para afatit normativ dokumentet e krijuara prej institucioneve te administratës shtetërore qendrore e vendore, ne rast rreziku te dukshëm dëmtimi a zhdukjeje fizike.
2. Ne këtë rast, si dhe kur veprimtaria e një institucioni shuhet, shpenzimet për përpunimin arkivor te dokumenteve përballohen nga institucioni fondkrijues, kur ky ekziston, ose nga institucioni i burimit te varësisë.

#### Neni 47

Dokumentet e subjekteve joshteterore, te personave juridike e fizike private, si dhe ato te personaliteteve shkencore, politike, kulturore, te krijuara jashtë përgjegjësive te tyre shtetërore, te shpallura me interes historik kombëtar, dorëzohen ne arkivat shtetërore me vullnetin e tyre ose te trashëgimtarëve, me marrëveshje.

#### Neni 48

Arkivat e përshkruar ne nenin 9 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d" dhe "dh" te këtij ligji janë te vetmet institucione shtetërore qe kane te drejtën e blerjes dhe te administrimit te trashëgimisë dokumentare dhe te dorëshkrimeve.

#### Neni 49

1. Studiuësit dhe punonjësit shkencore, qe bëjnë kërkime për projekte te institucioneve arkivore, kërkimore-shkencore shtetërore ne arkiva te vendeve te tjera dhe marrin prej tyre dokumente, janë te detyruar t'i dorëzojnë ato ne arkivin e institucionit ku punojnë, si dhe te dërgojnë ne arkivat shtetërore përkatës një relacion me përshkrime te hollësishme për sasinë dhe përmbajtjen e tyre.
2. Ne këto raste, studiuësit dhe punonjësit shkencore kane te drejtën e një kopjeje falas te dokumenteve. Kopja u ofrohet nga arkivi pranues.

#### Neni 50

Institucionet joshteterore, personat juridike e fizike private qe dhurojnë, lënë ne trashëgim a për ruajtje ose u shesin dokumente arkivave shtetërore, gëzojnë te drejtën për te marre, sipas marrëveshjes, riprodhime falas te tyre.

#### Neni 51

Ne rast te ndryshimeve ne organizimin administrativo-territorial, te riorganizimit te veprimtarisë se organeve shtetërore, njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ose arkivat shtetërore, te përshkruar ne nenin 9 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d" dhe "dh" te këtij ligji, për te vendosur për administrimin e mëtejshëm te dokumenteve.

#### Neni 52

Dokumentet e shpallura me rëndësi historike kombëtare ne pronësi a zotërim te subjekteve joshtetërore dhe personave juridike e fizike private, kur këto e shuajnë veprimtarinë e tyre ose nuk kane trashëgimtarë te njohur me ligj, depozitohen ne arkivat shtetërore.

#### KREU VII

#### KOMUNIKIMI DHE SHFRYTEZIMI I DOKUMENTEVE TE FONDIT ARKIVOR KOMBETAR

#### Neni 53

1. Shërbimi arkivor garanton te drejtën për t'u njohur me dokumentet qe dëshmojnë veprimtarinë e administratës shtetërore.
2. Personi dhe institucionet janë te barabarte ne te drejtën për shërbim arkivor.
3. Fondkrijuesit gëzojnë te drejtën e shfrytëzimit te dokumenteve ne çdo kohe, pavarësisht nga afatet e përcaktuara ne nenin 61 te këtij ligji.
4. Fondkrijuesit joshtetërore kane te drejtën e kufizimit te shërbimit me dokumentet e tyre ne afate te ndryshme nga ato te përcaktuara ne nenin 61 te këtij ligji.

#### Neni 54

1. Shërbimi arkivor ofrohet pa autorizim.
2. Shfrytëzimi i arkivave shtetërore e private u ofrohet kërkuesve, pavarësisht nga kombësia, shtetësia, statusi ose funksioni i tyre.
3. Autoriteti arkivor shtetëror, kur është e nevojshme, ofron vetëshërbim.

#### Neni 55

Kërkuesi i një dokumenti nuk është i detyruar te paraqesë arsye për t'u lejuar qe ta shfrytëzojë atë.

#### Neni 56

Kërkesa për shfrytëzim dokumentesh mund te mos pranohet nëse shërbimi për to është i kufizuar me ligj.

#### Neni 57

Nëse një arkiv nuk e ka dokumentin e kërkuar, kur është e mundshme, i tregon kërkuesit se ne cilin arkiv ose autoritet publik ndodhet.

#### Neni 58

Punonjësit e rrjetit arkivor kombëtar shërbejnë dokumentet besnikërisht me origjinalin, pa komente ose interpretime.

#### Neni 59

Mjetet e informacionit dhe te kërkimit arkivor janë te hapura. Shërbimi i tyre nuk mund t'i kufizohet askujt.

#### Neni 60

Shfrytëzimi i dokumenteve te fondit arkivor kombëtar behet sipas kërkesave te këtij ligji, nëpërmjet:

- a) shërbimit te dokumenteve ose riprodhimeve te tyre (mikrofilma, fotokopje) për studim ne sallat e leximit te arkivave;
- b) botimit te udhërrëfyesve, katalogëve, inventarëve, si dhe përmbledhjeve me dokumente;
- c) përgatitjes dhe hapjes se ekspozitave dokumentare. Ekspozimi i dokumenteve origjinale lejohet vetëm kur sigu rohet ruajtja fizike dhe teknologjike, sipas rregullave ne fuqi;
- ç) publikimit ne organet e shtypit, radios, medias, multimedias dhe kinematografisë;
- d) dhënies se burimeve institucioneve shtetërore e joshtetërore për problemet qe u interesojnë;
- dh) te gjitha formave te promocionit te vlerave kulturore qe ruhen ne arkiva;
- e) shërbimit te numerizuar ne distance. .

#### Neni 61

1. Dokumentet e publikuara një here janë lirisht te shfrytëzueshme.
2. Dokumentet qe administrohen ne institucionet arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kane kaluar 25 vjet nga data e krijimit.

#### Neni 62

Dokumentet qe përmbajnë te dhëna te rëndësishme për sigurimin e interesave te larte te shtetit, qe janë pranuar ne arkivat shtetërore para hyrjes ne fuqi te këtij ligji dhe nuk janë deklasifikuar ende, jepen për shfrytëzim, sipas kërkesave te ligjit nr. 8457, date 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"".

#### Neni 63

Arkivat mbrojnë jetën intime te personit. Ndalohet njohja, shfrytëzimi dhe publikimi i dokumenteve qe përmbajnë te dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën private te personit. Dokumentet qe përmbajnë te dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën intime te personit, shërbehen vetëm pasi kane kaluar, sipas rastit, 50 deri ne 150 vjet nga data e krijimit te tyre.

#### Neni 64

Dokumentet e pronësisë u shërbehen trashëgimtarëve te pronës, përfaqësuesve te tyre ligjore dhe institucioneve shtetërore, qe kane kompetenca vendimmarrëse te njohura me ligj për trashëgimin e pronave.

#### Neni 65

1. Institucionet publike ne veprim, qe kane autoritet klasifikues për arkivat e tyre dhe institucionet arkivore, qe kane trashëguar informacion te klasifikuar, mund te kufizojnë pjesërisht shfrytëzimin e dokumenteve arkivore, ne përputhje me ligjin nr.8457, date 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"".
2. Kufizime mund te zbatohen edhe ne funksion:
  - a) te mbrojtjes se sigurisë kombëtare dhe te normalitetit ne marrëdhëniet me jashtë;
  - b) te interesave te sigurimit publik;
  - c) te fshehtësisë për hetimin dhe ndjekjen e veprimtarive kriminale;

- c) te respektimit te interesave tregtare dhe te barazisë ne konkurrence;
- d) te moscenimit te barazisë se palëve ne një konflikt;
- dh) te mbrojtjes se ekosistemeve natyrore;
- e) te sigurisë se misioneve mbikëqyrëse, si dhe te kushteve për inspektim dhe kontroll nga administrata;
- ë) te mosdemtimit te politikës financiare, monetare dhe tatimore te shtetit;
- f) te respektimit te mirëbesimit ne vendimmarrje brenda ose ndërmjet autoriteteve publike, për përgatitjen e një dosjeje;
- g) te interesave te tjerë te individit, qe vlerësohen te ligjshëm nga institucionet e specializuara.

#### Neni 66

Shfrytëzimi i dokumenteve arkivore mund te lejohet edhe për rastet e parashikuara ne nenin 65, nëse një interes publik me i larte e përlligj hapjen.

#### Neni 67

1. Leje për shfrytëzim te parakohshëm te dokumenteve, qe u kufizohet shërbimi ne nenet 61, 62 dhe 63 te këtij ligji, jepen përkatësisht:

- a) nga fondkrijuesi;
- b) nga autoriteti klasifikues, për dokumentet e klasifikuara "sekret shtetëror";
- c) nga vete personi, për dokumentet qe përmbajnë te dhëna intime dhe qe kane te bëjnë me dinjitetin personal te tij.

2. Te drejtën e përjashtimit e kane, gjithashtu:

- a) Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, për dokumentet qe ndodhen ne Arkivin Qendror Shtetëror dhe ne arkivat shtetërore te qarqeve, pas marrjes se pëlqimit me shkrim te fondkrijuesit, kur ai ekziston;
- b) drejtuesi i institucionit, për dokumentet qe ruhen ne arkivat e sistemit ose ne arkivat qe administrojnë dokumente te se njëjtës tipologji;
- c) çdo subjekt i autorizuar me ligj.

#### Neni 68

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, rrjeti arkivor ne varësi te saj dhe çdo njësi e shërbimit arkivor pranë institucioneve te administratës shtetërore, qendrore e vendore, nuk kane autoritet klasifikues mbi dokumentet qe ruajnë e administrojnë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave bën deklasifikimin e dokumenteve te klasifikuara "sekret shtetëror", qe ka trashëguar, sipas përgjegjësisë qe i njej ligji nr.8457, date 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", si dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij.

#### Neni 69

Mjetet e informimit dhe te kërkimit arkivor bëjnë te ditur tërësinë e fondeve te dokumenteve te arkivave. Ato njoftojnë edhe për ekzistencën e dokumenteve te klasifikuara "sekret shtetëror", por pa deklaruar përmbajtjen e te dhënave te mbrojtura nga ligji.

#### Neni 70

1. Kur shfrytëzimi i një dokumenti arkivor është miratuar, shërbimi arkivor autorizon këshillimin e tij ne njërën nga format e ruajtjes (mikrofilm, riprodhim dhe origjinal) ose dhënien e kopjeve te certifikuara te tij. Shërbimi arkivor mban parasysht, brenda mundësive, zgjedhjen e kërkuesit për shërbim.

2. Fotokopje ose riprodhime ne forma te tjera jepen për te ilustruar botimet, për përgatitje

ekspozitash, si dhe për shërbime të tjera të ligjshme.

#### Neni 71

1. Kërkuesi ka të drejte të njihet me një arsye ligjore për mospranimin e shërbimit, duke përfshirë rastin e dokumentacionit të klasifikuar "sekret shtetëror".
2. Kërkuesi ka të drejte të kërkojë autorizim nga autoriteti klasifikues për t'u njohur me informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".
3. Autoriteti klasifikues mund të lejojë njohjen e pjesëshme, si rrjedhim, fshehjen e pjesëshme të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror". Kërkuesi vihet në dijeni për këtë.

#### Neni 72

Kërkuesi, të cilit nuk i pranohet shërbimi për dokumente të klasifikuara "sekret shtetëror", ka të drejtën e ankimit në gjykatë ose përpara çdo organi tjetër të paanshëm të parashikuar me ligj.

#### Neni 73

Shërbimi arkivor nuk është i detyruar të japë për shfrytëzim një dokument të botuar ose që është lehtësisht i shfrytëzueshëm në burime të tjera.

#### Neni 74

1. Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike krijuese të dokumenteve janë të detyruara:
  - a) të vënë në dijeni publikun për të drejtën për të shfrytëzuar dokumentet arkivore dhe për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte;
  - b) të sigurojnë ushtrimin e kësaj të drejte në dobi të interesave të shtetasve;
  - c) të kualifikojnë nëpunësit e tyre, për të kryer detyrat dhe detyrimet për zbatimin e kësaj të drejte.
2. Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike kanë për detyrë:
  - a) të bëjnë përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të tyre, duke i bërë lehtësisht të shfrytëzueshme;
  - b) të zbatojnë procedura të qarta për asgjësimin e dokumenteve pa vlerë ruajtjeje.

#### Neni 75

Autoritetet publike, me nismën e tyre, bëjnë të njohura burimet që kanë në dispozicion, në funksion të transparencës së veprimtarisë të administratës shtetërore, në shërbim të nxitjes së pjesëmarrjes të publikut në çështje me interes për të dhe në funksion të forcimit të shtetit të drejtës dhe të mirëqeverisjes.

#### Neni 76

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore bëjnë përpjekje të bashkërenduara, mutatis mutandis, për të lehtësuar kushtet e komunikimit të arkivave private me arkivat publike.

#### Neni 77

1. Kërkesat e institucioneve shtetërore e joshtetërore, si dhe të personave juridike e fizike private, për studime joshkencore, të dhëna arkivore, kopje ose ekstrakte dokumentesh, që ruhen në arkivat shtetërore, plotësohen kundrejt pagesës, sipas tarifave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
2. Shërbimi me fotokopje, për dokumente në funksion të studimeve shkencore universitare

akademike, behet me tarife te diferencuar favorizuese.

#### Neni 78

1. Sasia e dokumenteve te riprodhuara, qe i shërbehen kërkuesit, ne baze te flete-porosisë se tij, përcaktohet nga autoriteti arkivor shërbyes, ne përputhje me objektin e kërkesës.
2. Kërkuesit qe shtrembëron burimin ne përdorimin publik te dokumentit, nuk i shërbehen riprodhime.

#### Neni 79

1. Kur subjektet joshtetërore, personat juridike e fizike private, pronare ose zotërues a mbajtës te dokumenteve, nuk respektojnë detyrimet e parashikuara nga ky ligj, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përcakton një afat kushtetues, për te verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore. Nëse detyrimet nuk plotësohen brenda afatit kushtetues, dokumentet e tyre merren për ruajtje nga arkivat shtetërore.
2. Ne rast se shërbimi arkivor kombëtar vlerëson se ekziston rreziku i dëmtimit te menjëhershëm, qe mund te sjelle zhdukje te dokumenteve, ato merren ne administrim pa lënë afat kushtetues.
3. Ne te dyja rastet ruhet e drejta e pronësisë dhe e rikthimit te dokumenteve.

### KREU VIII

#### EKSPORTIMI DHE IMPORTIMI I DOKUMENTEVE

#### Neni80

1. Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, qe ruhen ne arkivat shtetërore ose private paraqiten ne mjedise ndërkombëtare, jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, për qëllime manifestimi, ekspozimi ose promovimi kulturor, si dhe për qëllime historike e shkencore, vetëm kur garantohet me marrëveshje ruajtja e integritetit dhe siguria e tyre fizike, ne udhëtim dhe ne kohen e veprimtarisë.
2. Vlera e sigurimit përcaktohet me marrëveshje, sipas standardeve ndërkombëtare, nga autoritetet e parashikuara ne nenet 82 dhe 83 te këtij ligji.

#### Neni 81

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, qe pësojnë dëmtime gjate transportit ose për shkak te mikromjedisit, ku do te vendosen gjate ekspozimit, nuk lejohet te paraqiten ne mjedise ndërkombëtare.

#### Neni 82

Leja për paraqitjen e dokumenteve te fondit arkivor kombëtar ne mjedise ndërkombëtare jepet:

- a) për dokumentet qe ruhen ne Arkivin Qendror Shtetëror dhe arkivat shtetërore vendore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
- b) për dokumentet qe ruhen ne arkivat shtetërore te sistemit dhe arkivat qe ruajnë dokumente te se njëjtës tipologji, nga drejtuesit e institucioneve te varësisë përkatëse;
- c) për dokumentet qe ruhen nga arkivat private, nga Këshilli i Larte i Arkivave.

#### Neni 83

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, qe përbejnë vlera unikale te trashëgimisë kulturore

kombëtare, te përcaktuara si te tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, paraqiten jashtë shtetit me vend im te Këshillit te Ministrave.

#### Neni 84

Autoritetet, qe kane te drejte për dhënie leje për paraqitjen e dokumenteve te fondit arkivor kombëtar ne mjedise ndërkombëtare, sipas neneve 82 dhe 83 te këtij ligji, janë te detyruara te përcaktojnë datën e sakte te rikthimit te tyre ne vendruajtjen e përhershme. Koha e qëndrimit jashtë shtetit nuk mund te jete me shume se një vit nga data e daljes nga territori i Republikës se Shqipërisë.

#### Neni 85

Ne rastin e lejimit te daljes se përkohshme te dokumenteve te fondit arkivor kombëtar jashtë territorit shtetëror, institucioni miratues është i detyruar t' i shoqërojë ato me lejet përkatëse për autoritetet doganore, sipas legjislacionit ne fuqi.

#### Neni86

1. Importimi i dokumenteve për pasurimin e arkivave te Shqipërisë behet sipas marrëveshjeve te nënshkruara nga palët bashkëpunuese.
2. Pasuritë arkivore, qe hyjnë ne rrjetin arkivor te Republikës se Shqipërisë përmes importit, shoqërohen me certifikatën qe përcakton identitetin dhe prejardhjen e tyre dhe me lejen e autoritetit dërgues.

#### Neni 87

Shteti shqiptar, sipas legjislacionit ne fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ka detyrimin te interesohet e te kërkojë rikthimin ne vend te dokumenteve te fondit arkivor kombëtar, qe kane dale ne mënyrë te paligjshme jashtë territorit shtetëror.

#### Neni 88

1. Kur ne territorin e Republikës se Shqipërisë vihet re se ka dokumente te një shteti tjetër, te hyra ne rruge te paligjshme, këto kalojnë ne ruajtje te përkohshme pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Arkivave, deri ne zgjidhjen përfundimtare te çështjes.
2. Nëse brenda pese vjetëve, pas publikimit te ekzistencës se këtyre dokumenteve, nuk paraqiten kërkesa për rikthimin e tyre ne vendin e prejardhjes, ato kalojnë ne pronësi te shtetit shqiptar.

### KREU IX ARKIVISTI

#### Neni 89

Punonjësi i rrjetit arkivor kombëtar te Republikës se Shqipërisë respekton Kodin Deontologjik Ndërkombëtar te Arkivisteve.

#### Neni 90

Arkivistet e rrjetit arkivor shtetëror nuk mund te jene anëtarë te partive politike. Përgjegjësia e



tyre si ruajtës të trashëgimisë dhe të informacionit rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe përcaktohet nga ligjet në fuqi.

#### Neni 91

Arkivistet janë të paanshëm në ofrimin e shërbimit për shfrytëzimin e dokumenteve dhe respektojnë kufizimin ligjor për mbrojtjen e të dhënave të jetës private të individit dhe të interesave të veçante të shtetit, pavarësisht se mund të njihen me to për shkak të detyrës.

### KREU X KUNDERVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

#### Neni 92

1. Autoritetet dhe punonjësit e arkivave shtetërore mbajnë përgjegjësi ligjore për shkeljen e kërkesave të këtij ligji. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbejnë veprë penale, përbejnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobe nga 1 deri në 5 paga mujore shkeljet e mëposhtme:

- a) mungesa e kushteve të nevojshme të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për ruajtjen fizike e teknologjike të dokumenteve;
- b) moszbatimi i kërkesave të këtij ligji dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve;
- c) mosdorëzimi në afat dhe sipas kërkesave të këtij ligji i dokumenteve në arkivat shtetërore;
- ç) mosdhënia e të dhënave të nevojshme për regjistrimin dhe evidencimin e veprimtarisë arkivore e të dokumenteve të tyre arkivave shtetërore, të përcaktuar me ligj;
- d) pengimi i punonjësve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për të kryer përgjegjësitë e tyre sipas këtij ligji.

2. Shkeljet që kanë të bëjnë me tjetërsimin e dokumenteve dhe humbjen e dokumenteve të arkivit nga persona që i kanë në administrim, kur ato nuk janë kopje e vetme, dënohen me gjobe nga 2 deri në 10 paga mujore.

3. Personat fizike e juridike private i nënshtrohen gjobës nga 100 mijë deri në 300 mijë leke kur kanë kryer shkeljet e përmendura në shkronjat "a", "ç", "d" të pikës 1 dhe pikën 2 të këtij neni.

4. Gjoba vendoset nga punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

5. Për botimin e burimeve arkivore në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, mbajnë përgjegjësi edhe kërkuesit. Kërkuesi që shkel në mënyrë të përsëritur rregulloren e shfrytëzimit të dokumenteve arkivore, ose dëmton vete dokumentet, mund të përjashtohet për një periudhë deri 1-vjeçare nga e drejta e shërbimit arkivor.

6. Kundër vendimit të dënimit me gjobe ose të përjashtimit, personat që kanë kryer shkeljet mund të bëjnë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

7. Asgjësimi i dokumenteve, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, vjedhja, si dhe humbja e dokumenteve të shpallura të një rëndësie të veçante, kur shkelja përbën veprë penale, dënohet sipas Kodit Penal.

### KREU XI DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 93

1. Masat për mbrojtjen e dokumenteve në kohe të veçante rrjedhin nga ligji nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile".

2. Rregullat e zhvendosjes (evakuimit), të shmangies dhe të risistemimit të dokumenteve në kohe të veçante përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 94

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenëve 9 pika 3, 14 pika 5, 15 pika 2, 25 pika 1, 36 pika 2, 83 dhe 93 pika 2 të këtij ligji.

Neni 95

Ligji nr. 7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat", shfuqizohet.

Neni 96

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4018, datë 2.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

---

Copyright 2010 - [www.ligjet.org](http://www.ligjet.org)